



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 15 janar 2019

Numri i lëndës: 2018-02

D.W.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 15 janar 2019, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaél METTRAUX, kryesuese
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. Ronald HOOGHIEMSTRA, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2019,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar në Panel me datën 19 qershor 2018.
2. Ankuesi ka kërkuar që Paneli mos t'i bëhen publike të dhënat e identitetit të tij. Në bazë të rrethanave të lëndës, Paneli ka miratuar kërkesën në fjalë.
3. Pas dorëheqjes së fundit të një prej anëtarëve të tij të përhershëm, Paneli do të mblidhet lidhur me këtë çështje vetëm me dy anëtarë në përputhje me Rregullën 11 dhe 14 të Rregullores së Punës së Panelit.

II. FAKTET

4. Faktet e lëndës, siç janë paraqitur nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë.
5. Për një periudhë dyvjeçare, ankuesi ka punuar në Policinë e Kosovës si anëtar i stafit civil.
6. Në vitin 2012, ankuesi ishte shkarkua nga puna e tij. Ankuesi pohon se Policia e Kosovës e kishte larguar nga puna në mënyrë që ta vriste.
7. Në vitin 2016, Agjencia Kosovare e Inteligjencës (AKI) gjoja se i kishte vendosur helm në qep të çajnikut, prej të cilit ankuesi ishte duke pirë çaj. Ankuesja pretendon se AKI-ja kishte bërë kërcënime me vdekje ndaj tij përmes telefonit qindra here dhe vazhdon ta bëjë këtë.
8. Ankuesi ka dërguar letra që kërkojnë ndihmë nga autoritetet gjyqësore ndaj këtyre kërcënimeve me vdekje, ndër të tjera nga Kryetari i Republikës së Kosovës dhe nga Kryeprokurori i shtetit të Republikës së Kosovës.
9. Në një datë të pasaktësuar, ankuesi thuhet se ka raportuar rastin e tij në EULEX përmes postës elektronike, por EULEX-i gjoja se si përgjigje nuk ka ndërmarrë asnjë masë.

III. ANKESAT

10. Pa përmendur ndonjë dispozitë të caktuar të instrumenteve për mbrojtjen e të drejtave të njerit, ankuesi pohon se ka marrë kërcënime me vdekje nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë dhe Policia e Kosovës. Ankuesi dëshiron që EULEX-i të sigurojë lirinë e tij nga këto kërcënime. Për nga përmbajtja e ankesës së tij, duket se ai pretendon në shkelje të të drejtave të tij *ndër të tjera* sipas nenit 2, 3 dhe 8 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe lirive themelore.

IV. LIGJI

11. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut, siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
12. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.
13. Sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, Paneli mund t'i shqyrtoj ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga

EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në gjyqësi, polici dhe dogana.

14. Në rastin në fjalë, Paneli vëren se nuk është argumentuar, e lëre më parë, se EULEX-i ishte në ndonjë mënyrë i përfshirë në shkeljet e supozuara të të drejtave të ankuesit. Nuk duket se ankuesi ka kërkuar asistencën apo përfshirjen e ndonjë organi përkatës të EULEX-it. E ankuesi nuk ka konstatuar as edhe se Misioni fajsisht ka dështuar të veproj në këtë çështje.
15. Përderisa Paneli pranon se çështjet e paraqitura nga ankuesi ngrisin shqetësime, ato nuk bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe nuk duket që janë brenda përgjegjësisë ekskluzive të autoriteteve vendore të Kosovës. Rrjedhimisht ato bien jashtë kompetencës së Panelit, siç është cekur në Rregullën 25 të Rregullores së Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë (shih *Shaip Gashi kundër EULEX-it*, 2013-20, 26 nëntor 2013, § 9, *Jovanka, Dragan dhe Milan Vuković kundër EULEX-it*, nr. 2013-18, 7 prill 2014, §§ 11-12).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë që të shqyrtoj këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (1) (d) të Rregullores së vet të Punës dhe

SHPLL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

Guénaël METTRAUX
Kryesues



Anna BEDNAREK
Anëtare